



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
S-042/43
Prishtinë, më 17 e 22 shtator dhe 1 e 8 tetor 2015

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 17 E 22 SHTATOR DHE 1 E 8 TETOR 2015**

Në fillim, seancën e kryesoi Sabri HAMITI, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari i hapi punimet e Sesionit vjeshtor të Kuvendit, përkatësisht të seancës plenare dhe u dëshiroi punë të mbarë deputetëve, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Nënkryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ramush Haradinaj, Bekim Haxhiu, Armend Zemaj, Glauk Konjufca, Zafir Berisha, Qerim Bajrami, Xhevahire Izmaku dhe Etem Arifi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Shqipe Pantina parashtroi pyetje për ministren Hykmete Bajrami në lidhje me atë se çfarë ka bërë Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorit ndaj, siç tha ajo, mashtrimeve që bëjnë qendrat tregtare, në raport me konsumatorët.

Ministrja Hykmete Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes Shqipe Pantina.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Skender Hyseni në lidhje me heqjen dorë nga shtetësia nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe sa është numri i tyre?

Ministri Skender Hyseni nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Abdullah Hoti në lidhje me afatet kohore për fillimin e zbatimit të sigurimeve shëndetësore.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Teuta Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me kriteret mbi bazën e të cilave është vendosur për renovimin e Spitalit të Vushtrrisë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me arsyet që po i detyrojnë anesteziologët ta braktisin sektorin publik dhe cilat janë veprimet konkrete që do të ndërmerren nga ministria që ai drejton.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtroi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa në lidhje me nënshkrimin e kryeministrit në Marrëveshjen lidhur me Asociacionin e Komunave Serbe, të arritur në Bruksel, më 25 gusht 2015.

Kryeministri Isa Mustafa nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me funksionalizimin e Klinikës së Kardiokirurgjisë.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me planet për ndërtimin e objektit të Shkollës Filllore “Agim Ramadani” në fshatin Haxhaj të Komunës së Gjilanit, në vitin 2016.

Ministri Arsim Bajrami nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Faton Topalli parashtroi pyetje për ministrin Arban Abrashi në lidhje me, siç tha ai, ndërprerjen e pensionit invalidor në shumë raste për qytetarët e vendit, të cilët janë të paafte për punë.

Ministri Arban Abrashi nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Besa Baftija parashtroi pyetje për ministrin Imet Rrahmani në lidhje me atë se pse u lejua hapja e Spitalit Amerikan në oborrin e QKUK-së.

Ministri Imet Rrahmani iu përgjigj pyetjes së deputetes Besa Baftija.

Deputeti Ismajl Kurteshi parashtroi pyetje për ministrin Arsim Bajrami në lidhje me ndalimin e procedimit në Kuvend të Projektligjit për arsimin e lartë nga ministrat serbë në Qeverinë e Kosovës.

Ministri Arsim Bajrami nuk ishte i pranishëm në sallë.

* * *

Në vazhdim, për plotësimin e rendit të ditës u paraqit deputeti Ismet Beqiri.

Kryetari i GP të LDK-së, Ismet Beqiri kërkoi që kërkesa e kryeministrit të Kosovës, z. Isa Mustafa për shtyrjen e pikës: “Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me

marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015” të pranohet nga Kuvendi, përkatësisht të shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi kërkoi deklaratimet e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Në lidhje me çështjen e lartpërmendur u deklaruan deputetët:

Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Ramush Haradinaj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Slavko Simiq - në emër të Grupit Parlamentar LS, Valdete Bajrami - në emër të Grupit Parlamentar “Nisma” dhe Myfera Shinik - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim kërkesën e kryetarit të GP të LDK-së për shtyrjen e pikës së rendit të ditës “Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015” për seancën e radhës.

Pas kësaj, deputetët e grupeve parlamentare opozitare të VV, AAK-së dhe “Nisma” dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryesuesit të seancës dhe penguan zhvillimin e punimeve të seancës..

Kryesuesi i seancës për ta tejkaluar situatën e krijuar dha pauzë prej 10 minutave.

Pas pauzës, përsëri deputetët e grupeve parlamentare opozitare të VV, AAK-së dhe “Nisma” qëndruan para foltores së drejtuesit të seancës dhe e pamundësuan zhvillimin e punimeve të Kuvendit me arsyetimin se seanca nuk mund të procedojë me pikat e tjera të ditës, para se kryeministri i Kosovës të raportojë në Kuvend për marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015.

Në këto rrethana, Kryesuesi e mbylli seancën e sotme në orën 12:17 minuta.

E martë, 22 shtator 2015, ora 11:00

Vazhdimi i seancës, e filluar më 17 shtator 2015

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e Kuvendit për të vazhduar me pikat e seancës plenare, e filluar më 17 shtator 2015.

Ai procedoi me pikat si në vijim:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa asnjë vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 30 e 31 korrik 2015, më 3 gusht 2015, si dhe seancave të jashtëzakonshme të mbajtura më 3 gusht 2015, në orën 21:00 dhe 23:15 minuta.

4. Raportimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel, më 25 gusht 2015

Kryetari i njoftoi deputetët e Kuvendit se kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, ka shprehur gatishmërinë që të raportojë në Kuvend lidhur me marrëveshjet e arritura në Bruksel më 25 gusht 2015, që kanë të bëjnë me:

1. Konkluzionet e lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së energjisë të vitit 2013,
2. Konkluzionet e Grupit Punues për Urën / Liria e lëvizjes,
3. Plani i veprimtimit i Telekomit dhe
4. Asociacioni / Bashkësia e komunave me shumicë serbe, principet e përgjithshme, elementet kryesore.

Ai e ftoi kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, që ta marrë fjalën.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa tha se katër marrëveshjet e arritura Bruksel, më 25 gusht 2015:

- Asociacioni / Bashkësia e komunave me shumicë serbe, principet e përgjithshme, elementet kryesore.
- Konkluzionet e lehtësuesit të BE-së për zbatimin e Marrëveshjes së energjisë të vitit 2013,
- Plani i veprimtimit të Telekomunikacionit dhe
- Konkluzionet e Grupit Punues për Urën mbi lumin Ibër, përkatësisht heqja e barrikadave nga ura, janë marrëveshje që derivojnë nga marrëveshja e parë e ratifikuar me ligj nga Kuvendi i Kosovës, të cilat janë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi.

Gjatë raportimit të kryeministrit në Kuvend, disa deputetë të grupeve parlamentare nga opozita gjuajtën vezë në drejtim të kryeministrit. Në pamundësi për të raportuar, kryeministri e ndërpreu fjalimin dhe i shoqëruar nga sigurimi i tij e lëshoi sallën e seancave.

Kryetari i Kuvendit e dënoi këtë gjest të deputetëve opozitarë dhe për tejkalimin e situatës së krijuar dha pauzë prej 10 minutave.

* * *

Pas pauzës, kryetari me të deklaruar vazhdimin e seancës plenare, deputetët e grupeve parlamentare opozita dolën para ulësës së kryetarit dhe para foltores së Kuvendit dhe pamundësuan vazhdimin e punimeve të seancës plenare.

Kryetari dha pauzë prej 15 minutave dhe i ftoi kryetarët e grupeve parlamentare në një konsultë të përbashkët lidhur me tejkalimin e situatës së krijuar në Kuvend.

Pas pauzës, kryetari u përpoq të vazhdojë me punimet e seancës plenare, por deputetët e grupeve parlamentare nga opozita përsëri dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulësës së kryetarit.

Kryetari dha pauzë prej 30 minutave dhe i ftoi kryetarët e partive politike të opozitës në një konsultë të përbashkët lidhur me tejkalimin e situatës së krijuar në Kuvend.

E martë, 1 tetor 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Para se kryetari i Kuvendit të procedojë me hapjen e punimeve të seancës plenare, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryetarit të Kuvendit dhe pamundësuan zhvillimin e punimeve të seancës.

Në lidhje me situatën e krijuar, kryetari kërkoi deklaratimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Për këtë çështje u deklaruan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Arben Gashi - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Glauk Konjufca - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, si dhe të grupeve parlamentare të opozitës, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari tha se të gjitha mosmarrëveshjet duhet zgjidhen nëpërmjet dialogut dhe çdo deputet do ta ketë rastin të diskutojë dhe ta shprehë qëndrimin e tij. Ai shtoi se nuk do të lejojë hyrjen e pjesëtarëve të sigurimit në sallën e seancave.

Kryetari dha pauzë 30 minuta dhe i ftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare në një takim të përbashkët në zyrën e tij.

Pas pauzës, përsëri deputetët e grupeve parlamentare opozitare dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryetarit të Kuvendit dhe pamundësuan zhvillimin e punimeve të seancës.

Në situatën e krijuar, kryetari i ndërpreu punimet e seancës plenare për ditën e sotme dhe i njoftoi deputetët se edhe seanca plenare e paraparë për datën 2 tetor 2015 nuk do të mbahet.

Kryetari mbylli punimet e seancës së sotme në orën 11:40 minuta.

E martë, 8 tetor 2015, ora 10:00

Vazhdimi i seancës

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Para se të procedohet me pikat e rendit të ditës, deputetët e grupeve parlamentare nga opozita dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulëses së kryetarit të Kuvendit, duke fishkëllyer penguan fillimin e punimeve të seancës.

Në situatën e krijuar, kryetari i ftoi mediat që i përcillnin punimet e Kuvendit që të hyjnë brenda në sallën e seancave dhe në praninë e tyre për të biseduar me përfaqësuesit e grupeve parlamentare për zgjidhjen e situatës së krijuar.

Pastaj, kryetari dha pauzë gjysmë ore.

Pas pauzës, përsëri deputetët e grupeve parlamentare nga opozita dolën para foltores së Kuvendit dhe para ulësës së kryetarit të Kuvendit dhe duke fishkëllyer e pengonin zhvillimin e punës normale të seancës plenare.

Kryetari u përpoq të bisedojë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare të opozitës, të cilët e pengonin zhvillimin e punimeve të seancës, për të gjetur një zgjidhje të situatës së krijuar.

Por, biseda nuk rezultoi me sukses. Atëherë, në situatën e krijuar, kryetari e autorizoi nënkryetarin e Kuvendit, z. Xhavit Haliti, që ta kryesojë seancën nga ulëset e deputetëve të GP të PDK-së.

Kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, mbajtur më 5 tetor 2015, ka vendosur që vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 17 e 22 shtator 2015, dhe seanca e mbetur më 1 tetor 2015, të vazhdojë vetëm me shqyrtimin e projektligjeve.

Kryesuesi propozoi që tri pikat e parapara për shqyrtim për këtë seancë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin; 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, dhe 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut për Projektin e Bashkëpunimit për Zhvillim: “KSV/018: Mbështetje Institucionale dhe Teknike për Sistemin e Furnizimit me Ujë në Rajonin e Mitrovicës”, të shtyhen për seancën e radhës, të cilën e miratoi Kuvendi.

Pastaj kryesuesi procedoi me rendin e ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë termike,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Gjatë kësaj kohe, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës qëndruan para foltores së Kuvendit dhe para deputetëve të grupeve parlamentare të opozitës, duke fishkëllyer gjatë gjithë kohës së punimeve të seancës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij

Kryesuesi tha se Projektligji për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij është propozuar nga deputeti Raif Qela, i mbështetur edhe nga 47 deputetë tjerë nënshkrues.

Ai theksoi se Qeveria e Kosovës nuk i ka dërguar mendim Kuvendit lidhur me këtë projektligj.

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e deputetëve nënshkrues për hartimin e këtij projektligji që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obilikut dhe rreth tij.

Në emër të propozuesit të këtij projektligji askush nga deputetët nënshkrues nuk e mori fjalën.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obilikut dhe rreth tij.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin Nr. 05/L-044 për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obilikut dhe rreth tij.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për Zonën e Rrezikuar Mjedisore të Obilikut dhe rreth tij dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës.

Në emër të Qeverisë si propozues i këtij projektligji nuk e mori fjalën askush.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 69,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-051 për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në emër të Qeverisë si propozues i këtij projektligji nuk e mori fjalën askush.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi - në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Slavko Simiq - në emër të Grupit Parlamentar LS, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar "6+", diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-041 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë termike

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për energjinë termike.

Në emër të Qeverisë si propozues i këtij projektligji nuk e mori fjalën askush.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Adem Grabovci - në emër të

Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për energjinë termike.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-052 për energjinë termike.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri si dhe Komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për energjinë termike dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Dizajnin Industrial.

Në emër të Qeverisë si propozues i këtij projektligji nuk e mori fjalën askush.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetë: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Adem Grabovci - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për dizajnin industrial.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-058 për dizajnin industrial.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për dizajnin industrial dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Në emër të Qeverisë si propozues i këtij projektligji nuk e mori fjalën askush.

Deputeti Albin Kurti, gjatë kësaj kohë sa ishte duke u zhvilluar seanca, e ndezi një materie të gazit lotsjellës në sallën e seancës plenare, gjë që e vështirësoi edhe më shumë zhvillimin e punimeve të seancës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa - në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri,

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

Kryesuesi i seancës, Xhavit Haliti, i mbylli punimet e seancës plenare në orën 11:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale